

Tiranë, më 6.9.2019

Njoftim për shtyp

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Gjatë seancës gjyqësore, subjekti i rivlerësimit parashtroi prapësimet e tij lidhur me analizën financiare, të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, dhe i kërkoi Kolegjit të Posaçëm të Apelit rihapjen e pjeshme të hetimit gjyqësor, duke paraqitur edhe prova të reja në proces.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi kryerjen e një analize të plotë të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016 dhe administrimin e provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

Seanca gjyqësore e radhës do të zhvillohet më datë 25.9.2019, ora 10:00.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi, shtesa e ankimit dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.